

Komisioni parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"

Komisioni parlamentar për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik, zgjedh Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", për mbledhjen e tij të radhës. Në një bashkëbisedim me Rektorin e Universitetit, Prof.dr. Skender Topi dhe personelin akademik, u diskutua mbi problematikat që shoqërojnë sot programet e studimit të mësuesisë dhe mundësitë e zgjidhjes së tyre, mbi çështjet e titujve dhe gradave shkencore, zhvillimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor etj.



